




Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
*Qeveria – Vlada – Government*

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /  
Ministry of Culture, Youth and Sports

Kabineti i Ministres  
Kabinet Ministra  
Minister's Office



Nr. 88/2020

Datë: 06.08.2020

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Vlora Dumoshi, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L – 113 për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenet 8 (paragrafi 1.4), 14 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.3), si dhe Shtojcën 3 (tre) të Rregullores Nr. 06/2020 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenet 33 dhe 38 të Ligjit Nr. 02/L-57 për Institucionet e Kulturës, nenet 49 dhe 50 të Ligjit Nr. 02/L-59 për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, nenin 9 të Statutit të Baletit Kombëtar të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr. 01/2016 për Punën e Këshillit Drejtues të Baletit Kombëtar të Kosovës, mori këtë:

#### V E N D I M

1. Emërohet Këshilli Drejtues i Baletit Kombëtar të Kosovës.
2. Këshilli Drejtues i Baletit Kombëtar të Kosovës ka këtë përbërje:
  - 2.1 Leonora Rexhepi;
  - 2.2 Luljeta Ademi;
  - 2.3 Lejla Pula;
  - 2.4 Agim Selimi;
  - 2.5 Zetlana Bahtiri-Gimolli, përfaqësuese e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
3. Këshilli Drejtues emërohet me mandat 4 (katër) vjeçare dhe është përgjegjës të ushtrtoj kompetencat e përcaktuara në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Anëtarët e Këshillit Drejtues si në paragrafin 1 të këtij vendimi, bazuar në Rregulloren Nr. 01/2016 për Punën e Këshillit Drejtues të Baletit Kombëtar të Kosovës, kompensohen financiarisht për punën e tyre.

5. Kompensimi lejohet në vlerë prej 125.00 (njëqind e njëzet e pesë) euro për Kryetarin e Këshillit, ndërsa nga 100.00 (njëqind) euro për anëtarët e Këshillit.
6. Kryetari dhe Anëtarët e Këshillit Drejtues paguhen vetëm për dy takime të mbajtura brenda muajit.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

*Vendimi i dërgohet:*

- *Kabinetit të Ministres;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit të Kulturës;*
- *Departamentit Ligjor;*
- *Baletit të Kosovës;*
- *Arkivit të MKRS – së;*

